




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIK OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr Prot. Br. Prot. <u>01-3094/13</u>
Nr. i faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>30.09.2013</u>
PRISTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	12.09.2013
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	Zyrtarët e Lartë Publik të Institucioneve Komunale të Republikës së Kosovës
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me parandalimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve të lartë publik të institucioneve komunale gjatë ushtrimit të funksionit publik



Të nderuar,

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 nënparagrafi 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 dhe 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Obligohen të gjithë zyrtarët e lartë publik, ushtrues të funksioneve publike në institucionet komunale të Republikës së Kosovës, të parandalojnë konfliktin e interesit në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Sipas ligjit, zyrtarët e lartë publik të institucioneve komunale janë:

Kryetarët dhe Zëvendës Kryetarët e Komunave, Kryesuesit, Zëvendës Kryesuesit, Këshilltarët e Asambleve Komunale dhe të gjithë Drejtorët e Drejtorive Komunale (neni 4, paragrafi 1.10 i Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik).

Agjencia kundër Korrupsionit me këtë opinion këshillon të gjithë kandidatët e zgjedhur për pozitat e lartpërmendura, që të parandalojnë konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik konform nenit 14 (paragrafi 2) dhe nenit 8 (paragrafi 1 dhe 2) të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Të gjithë zyrtarët e lartë publik të lartpërmendur kanë për obligim parandalimin e konfliktit të interesit konform nenit 8 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili parasheh detyrimet e zyrtarit të lartë për parandalimin e konfliktit të interesit.

Në bazë të këtij neni, zyrtari i lartë ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tij të interesit.

Rrjedhimisht, në qoftë se zyrtari i lartë është në dyshime për ekzistimin e konfliktit të interesit ai duhet të këshillohet me udhëheqësin e tij. Në rast se udhëheqësi i tij nuk është i bindur për ekzistimin e konfliktit të interesit atëherë i drejtohet Agjencisë për marrje të vendimit (paragrafi 2 dhe 5 i nenit 8).

Përveç kësaj, sipas nenit 16 (paragrafi 1) të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, zyrtarët e lartë publik, përfshirë Kryetarët dhe Zëvendës Kryetarët e Komunave, Kryesuesit, Zëvendës Kryesuesit, Këshilltarët e Asambleve Komunale dhe të gjithë Drejtorët e Drejtorive Komunale, nuk mund të jenë menaxhues ose anëtar të organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, përjashtuar subjektet politike.

Krahas ushtrimit të funksionit të tyre publik, zyrtarët e lartë nuk mund të ushtrojnë edhe veprimtari të tjera (paragrafi 2 dhe 3 i nenit 16).

Bazuar në këto dispozita, të gjithë zyrtarëve të lartë publik të lartpërmendur, u rekomandojmë që të ndërmarrin të gjitha masat, konform këtij opinioni të bazuar në ligjin në fuqi, që të parandalojnë konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Me respekt!